

MARREDHENIET KONTRAKTUALE TË FURNIZIMIT

Detyrimet kontraktuale të shitjes së energjisë.

- Frekuenca e leximit të matësit – cdo muaj dhe dërgon faturën brenda datës 25 të muajit që bën leximin;
- Mënyra e pagesës – Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse;
- Kamatvonesa – Pas kalimit të afatit të pagesës (prej 30 ditësh), Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me **0.1 %** të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.
- Kontrolli i aparatit matës- jo më vonë se 5 ditë punë prej ditës së paraqitjes së kërkesës nga klienti.
- Faturimi i energjisë elektrike gjatë periudhës së mosfunksionimit të aparatit mates- Në rast se të dhënat e aparatit të matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese, nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj. Në rastet kur klienti nuk e paguan detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit, 48 orë përpara.
- Rilidhja bëhet brenda 48 orësh, nga kryerja e pagesës së detyrimit dhe me kërkesë të Klientit. Në rastet e ndërprejeve aksidentale të furnizimit, Furnizuesi do të rivendosë furnizimin sa me shpejt që të jetë e mundur.
- Riaktivizimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike, pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit, i cili do të garantojë furnizimin me energji brenda 48 orëve, nga momenti i depozitimit të kërkesës, ndersa ndërpreja e furnizimit 15 ditë kalendarike pas kërkesës së klientit.
- Kur klienti kërkon shtesë fuqie, përgjigja jepet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.